



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 128 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, gjatë ditës së votimit, në largësinë prej 50 metrash nga qendra e votimit 2501/Y, përkatësisht në shkollën “Ahmet Hoxha”, janë vërejtur posterë të kandidatit për kryetar komune të subjektit politik LDK- Adem Salihaj.

Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike të nenit 3, paragrafi 4.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë e posterëve të kandidatit të subjektit politik LDK, për Kryetar Komune të Ferizajt, Adem Salihaj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP, pretendohet se në QV 2501/Y, në afërsi prej 50 metrash janë vendosur posterat e kandidatit të subjektit politik LDK, Adem Salihaj, PZAP-i vlerësoi se pretendimet ankimore dhe gjeti pretendimet e tilla nuk qëndrojnë ngase nga provat e bashkangjitura në ankesë nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin në marrjen masave ndëshkimore për faktin se nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet objekti se a është QV-ja, në të cilën pretendohet, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

A nr. 128/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muharrem Shala**

